



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 260/12 prot.,

Datë 18.02.2026

V E N D I M
Nr. 271/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë Agron Balukja dhe “T & J Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-73621-01-05-2026 me objekt: “Blerje materiale për sektorin e mirëmbajtjes”, me fond limit 5,996,700 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.

Ankimues: Operatori ekonomik Ervin Luzi me Nipt K71707007Q dhe adresë: Lagja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Gucia, Godina nr.5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Cërrik
Lagja nr.2 rruga “Gjimnazistet 1962”, Cërrik

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Agron Balukja” me Nipt L72909202H dhe adresë: Lagja “Clirimi”, Rruga “Sul Misiri”, Zona kadastrale 8522 , Pasuria nr 10/340, Elbasan

Operatori ekonomik “T & J Konstruktion” SHPK me Nipt M29718101T dhe adresë: Lagjja Teqe, zk.2908, pasuria nr.7/90, Peqin

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi Ervin Luzi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.01.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-73621-01-05-2026 me objekt: “Blerje materiale për sektorin e mirëmbajtjes”, me fond limit 5,996,700 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.

II.2. Në datën 16.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 16.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. ERVIN LUZI	5.390.000 lekë kualifikuar
2. Agron Balukja	4.500.000 lekë kualifikuar
3. “FREDI ELECTRONIC” SHPK	5.508.900 lekë kualifikuar
4. “SAM-ARS 2016” SHPK	5.467.000 lekë kualifikuar
5. “T&J Construction” SHPK	5.322.500 lekë kualifikuar

II.4. Në datën 22.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6286 datë 28.01.2026 dhe me nr.260 prot., datë 28.01.2026 e operatorit ekonomik Ervin Luzi, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave së operatorëve ekonomikë Agron Balukja dhe “T & J Konstruktion” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimin si më poshtë:

“.....Duke qenë se nuk jemi dakord me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Agron Balukja” dhe “T&J Konstruktion”, po paraqesim këtë ankesë me argumentat si më poshtë vijon:

Në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deri ditën e prokurimit mostrat e kërkuara në tabelën e mëposhtme:

Kosh metalik

Ndricues rrugor led 150W

Varg dritash 100m

Kapak zgare celiku

Ndërsa në shtojcën “Specifikime teknike”, për produktet për të cilat ka kërkuar mostrat e mësipërme, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Nr	Emertimi	Specifikime	Njesia	Sasia
11	Kosha metalik	Kosha metalik 1100 litrosh cilesor me shkrimin bashkia Cerrik	cope	28

16	Ndricues rrugor led 150W	Ndricues LED per rruge 150W, kundraujit, me panel, 6500K 750Lm	cope	100
26	Dekor vargje dritash	Drita dekorative LED. Ngjyrë gold. Per perdorim te jashtem Gjatësia: 100 metër.	cope	100
3	Kapak zgare Celiku	Kapak zgare Celiku (50x50cm)	cope	20

Në datën 16.01.2026, jemi paraqitur pranë autoritetit kontraktor për të dorëzuar mostrat për artikujt sipas përcaktimeve në DST, vërtetuar me procesverbalin nr. 159 prot., datë 16.01.2026. Në të njëjtën kohë është paraqitur edhe operatori ekonomik “Agron Balukja”.

Gjatë dorëzimit të mostrave me sy të lirë konstatoam se mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Agron Balukja”, nuk ishin sipas specifikimeve teknike, pasi:

Artikulli “Kosh metalik” nuk ishte kosh 1100 litrosh sikurse ishte përcaktuar në specifikime teknike, por ishte një kosh për cigare;

Artikulli “Ndricues rrugor led 150W”, nuk ishte me panel, por ishte ndricues 220v, me tre poca 150W;

Artikulli “Dekor vargje dritash”, është paraqitur një varg me portollampa (pa llampa të vendosura) dhe gjatësia ishte 10 m, jo 100 m sikurse është kërkuar. AK ka kërkuar drita dekori për festa, ndërkohë që mostra e sjellë nga ky operator ekonomik nuk ishte e tillë.

Artikulli “Kapak zgare celiku” nuk është paraqitur fare nga ky operator ekonomik.

Ndërsa operatori ekonomik “T&J Construction”, nuk është paraqitur fare, si dhe nuk ka sjellë asnjë mostër.

Sa më sipër, mostrat i shërbejnë autoritetit kontraktor, për tu siguruar dhe krijuar bindjen se produktet e ofertuara nga operatorët ekonomikë i plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara, si dhe janë sipas nevojave të kërkuara.

Nga ana tjetër, kërkesa për paraqitjen e mostrave është vendosur si kriter i vecantë kualifikimi, cka do të thotë se ka qenë i detyrueshëm për tu përmbushur nga të gjithë operatorët ekonomikë ofertues.

Në ligjin për prokurimin publik, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përcaktohet qartë se ofertat duhet të paraqiten në përputhje të plotë me kërkesat, kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor. Në rast se një ofertë nuk plotëson qoftë edhe një prej kriterëve apo specifikimeve teknike, përbën shkak për skualifikim. Fakti që komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar të gjithë operatorët ekonomikë edhe pasi nuk kanë paraqitur asnjë mostër, apo dhe ato që janë paraqitur janë jo në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, është një trajtim jo i drejtë ndaj operatorëve ekonomikë që janë angazhuar seriozisht për të plotësuar cdo kriter të dokumenteve të tenderit, si dhe kanë shpenzuar kohë, mund dhe para për të përgatitur për mostrat e paraqitura.

Në këto kushte, duke qenë se operatorët ekonomikë “Agron Balukja” dhe “T&J Construction”, kanë paraqitur mostra jo sipas specifikimeve teknike, apo nuk kanë paraqitur fare mostra, ofertat e paraqitura nga këta operatorë ekonomikë duhet të skualifikohen.....”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën

dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 260/1 prot., datë 28.01.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik Ervin Luzi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik Agron Balukja dhe operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Me shkresën nr.264, datë 29.01.2026, protokolluar me tonën nr. 260/2 prot., datë 29.01.2026, të ardhur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar nga autoriteti kontraktor shkresa me objek “Kthim përgjigje” mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e saj.

E njëjta shkresë është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar e cila është protokolluar me tonën nr. 260/3 prot., datë 02.02.2026.

II.8. Me shkresën nr. 260/4 prot., datë 02.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar autoritetit kontraktor me kërkese për dorëzimin e mostrave për procedurën e prokurimit të sipërmendur si dhe dokumentacionin shoqërues.

II.9., Në përgjigje të shkresës tonë nr.260/4, datë 02.02.2026 me objekt “Kërkesë për dorëzim të mostrave” autoriteti kontraktor me shkresën nr.429/1 prot., datë 04.02.2026, protokolluar me tonën nr.260/5, datë 09.02.2026, dorëzoi pranë KPP procesverbalet e administrimit të mostrave nga operatori ekonomik Agron Balukja dhe foto të këtyre mostrave.

II.10. Nisur nga fakti që autoriteti kontraktor nuk ju përgjigj kërkesës tonë për dërgim mostrash por dërgoi vetëm peocesverbalet dhe foto të mostrave, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua përsëri autoritetit kontraktor me shkresën nr.260/6 prot., datë 10.02.2026 për dërgimin fizik të mostrave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë.

II.11. Me shkresën nr.568/1 prot., datë 12.02.2026 protokolluar me tonën nr.260/7, datë 13.02.2026, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin i Prokurimit Publi , mostrat për procedurën e prokurimit të sipërmendur.

II.12. Referuar mostrave të dorëzuar nga autoriteti kontraktor më datë 13.02.2026 pranë KPP nga ana jonë u konstatua se mungonte një mostër Në këto kushte KPP ju drejtua me shkresën nr.260/8 prot., datë 16.02.2026 për dorëzimin e mostrës “Kapak zgare çeliku”.

II.13. Me shkresën nr.631/1 prot., datë 17.02.2026 protokolluar me tonën nr.260/9, datë 17.02.2026, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin i Prokurimit Publi , mostrën “Kapak zgare çeliku”.

II.14. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime

nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Ervin Luzi për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik Agron Balukja dhe operatorit ekonomik “T&J Construction” SHPK të kriterit **2.3.6** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deri ditën e prokurimit mostrat e kërkuara në tabelën e mëposhtme....*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.6 në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“2.3.6 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deri ditën e prokurimit mostrat e kërkuara në tabelën e mëposhtme:*

1. *Kosh metalik*
2. *Ndricues rrugor led 150W*
3. *Varg dritash 100m*
4. *Kapak zgare celiku .”.*

III.1.2. Në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumenteve të tenderit të modifikuara me shtojcën e datës 09.01.2026, të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimet teknike :

Nr	Emertimi	Specifikime
1	Xhama per shkollat	Xham i bardhe me trashesi 4 mm me peshe 10 kg/m2 me ngjyre natyrale me drite te transmetuar 88-90 %
2	Barriera Hekuri	Barriera me tub hekurite fi 32 mm me trashesi tubi 3mm .Me permasa 1x1x1 m me d=tub lidhes ne mes 90 cm
3	Kapak zgare Celiku	Kapak zgare Celiku (50x50cm)
4	Kapak pusetash gize	Kapak pusetash gize (50x70 cm) 1 cope, (40x63.5 cm) 1 cope, (90x90) 1 cope
5	Kapak pusetash Betoni	Kapak b/a C16/20 t= 10 cm (170x200 cm) 1 cope, (50x125 cm) 2 cope, (120x120 cm) 1 cope, (100x120 cm) 1 cope, (ø80cm) 2 cope, (ø120cm) 1 cope, (100x125 cm) 1 cope, (127x107 cm) 1 cope, (ø100 cm) 1 cope.
6	Cakull	Materiali guror duhet te kete fortesine 600 – 800 kg/cm2 , 16 - 30 %, permbajtje te argjiles me pak se 10 % dhe permbajtje te mbeturinave bimore me pak se 5 %.
7	Zhavor	Zhavor i copetuar me madhesi 16-32 mm me dendesi 1.4-1.7 t/m3
8	Rere	Rere lumi me madhesi 0-4 mm me lageshti 3-8% me dendesi 1.4-1.6 t/m3 pa materiale organike

9	Laptop	Laptop Lenovo ThinkPad P14s Gen 5 (ose ekuivalent), Intel Core Ultra 7 155H, 14.5", 32GB RAM, 1TB SSD, NVIDIA RTX 500, i zi
10	Kompjuter All in One	Kompjuter AIO HP ProOne 240 G10 (ose ekuivalent), Intel Core i5-1335U, 16GB RAM, 512GB SSD, Intel Iris Xe, i zi
11	Kosha metalik	Kosha metalik 1100 litrosh cilesor me shkrimin bashkia Cerrik
12	Aparat fotografik per sherbimet	Garancia: 1 vit, Incizim zëri: po, Viewfinder optik/elektronik: po, Wi-Fi:po, Bluetooth:po, Regjistrimi i videos: po, Lartësia e sensorit [mm]:13, Lloji i baterisë: Li-ion, Micro 4/3, Gjerësia e Sensorit [mm]: 17,3, Ndjeshmëria maksimale [ISO]: 25 600, Lente në pako: 12-60mm, Rezolucioni i ekranit LCD: 1 840 000, Paketimi: set, Pjerresi:PO, Formati i Sensorit: Fullframe, Mjeti/mediumi i regjistrimit: SD, SDHC, SDXC, Panel me prekje:po, Rezolucioni maksimal i videos: 4K, Formati i dosjes: JPEG, MOV, MP4, RAW,
13	Elektrogur	BOSCH ose ekuivalent SET ELEKTROGUR 2COPE, GWS 20-230JH + GWS 880
14	Matrapik	MATRAPIK PA KARBONÇINA MHEV 5 BL (ose ekuivalent) Maks. energjia me goditje të vetme (EPTA): 8.7 J Shkalla maksimale e ndikimit: 2900 bpm Fuqia hyrëse e vlerësuar: 1150 W Mbajtës bit: SDS-maks
15	Boje plastike e gatshme	Boje plasike cilesore e parapregatitur me pigmente ne kompjuter me ngjyryes sipas kerkeses se AK plasike per ambjente te jashtme
16	Ndricues rrugor led 150W	Ndricues LED per rruge 150W, kundraujit, me panel, 6500K 750Lm
17	Leshues 63A	Automat,Nderpreres magneto-termik 4P, 4M 63A Kurba C,6kA Easy9
18	Sensor kohe	Sensor drite BRAYTRON ose ekuivalent, 220V-240V AC
19	Kabell 1x2.5 mm2	Kabell 1x2.5 mm2
20	Krahe per ndricues	Krahe metalik 1.5mx0.5m
21	Kolle	kolle me thase 25 kg
22	Stuko	stuko me thase 25 kg
23	Spote per fasada	SPOTe LED 30W 6500K RRETHOR INKASO
24	Dekor vargje me rrjete	Vargje ne forme rrjete me permasa 6x4 me prize lidhese e cila mundeson lidhjen e disa vargjeve njekohesisht. Ngjyra e verdhe e ngrohte

25	Dekor veshje peme/tuneli	E ndërthurur nga degë jeshile Element dekorues, i kombinueshëm lehtësisht me çdo ambient. Ndërtuar me material rezistent PE + PVC. Strukturë metalike e përthyeshme. Gjatësia e degës: 270cm.
26	Dekor vargje dritash	Drita dekorative LED. Ngjyrë gold. Per perdorim te jashtem Gjatësia: 100 metër.
27	Dekor Kristale akulli	Dekor Kristale akulli me permasa 1m x1 m me drita led te bardha
	Shuma	Shuma
	TVSH%	tvsh 20%
	Totali	

III.1.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 264 prot, datë 29.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 260/3 prot datë 02.02.2026, lidhur me tratimin e ankesës së operatorit ekonomik Ervin Luzi për skualifikimin e operatorit ekonomik “T&J Construction” SHPK dhe Agron Balukja rezulton se Operatori ekonomik “T&J Construction” SHPK nuk ka paraqitur mostra ndërsa operatori ekonomik Agron Balukja për përmbushjen e kriterit kualifikues të sipërpërmendur ka dorëzuar përkatësisht mostrat e kërkuara për disa nga artikujt objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

- Referuar procesverbalit “Procesverbal i dorëzimit të mostrave për procedurën me objekt “Blerje materiale për sektorin e mirëmbajtjes” të datës 16.01.2026, të nënshkruar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik ofertues Agron Balukja, rezulton se ky operator ekonomik ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datën 16.01.2026 (me shkresën nr.103 prot., datë 13.01.2026), mostrat për artikujt e mëposhtëshënuar:

1. Kosh metalik
2. Ndricues rrugor led 150W
3. Varg dritash 100 m
4. Kapak zgare Celiku

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- c) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

- “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
- 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”.

II.1.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/a, e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti 15 kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Për sa i përket pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues mbi skualifikimin e ofertës së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues Agron Balukja, me pretendimin se: “mostrat e dorëzuara nga kjo kompani për artikujt e kërkuar në pikën 2.3.6 të DST nuk janë sipas specifikimeve të kërkuara në DST”, KPP nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pikën

2.3. “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit, ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deri në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe përkatësisht datën 16.01.2026, nga një mostër për disa nga produktet objekt prokurimi dhe konkretisht për produktet si në vijim: “Kapak zgare Celiku; Ndricues rrugor led 150W; Dekor vargje dritash Drita dekorative LED; Kosh metalik”, sipas procedurës për dorëzimin e tyre të përcaktuar në këtë kriter kualifikues, me qëllim që të krahasojë nëse produktet e ofruara i plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, ku në këtë shtojcë ka përcaktuar si në vijim: “Kapak zgare Celiku (50x50cm); Ndricues rrugor led 150W kundraujt, me panel, 6500K 750Lm; Dekor vargje dritash Drita dekorative LED. Ngjyrë gold për përdorim të jashtëm Gjatësia: 100 metër; Kosha metalik 1100 litrosh cilësor me shkrimin Bashkia Cërrik”. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe mostrave të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP më datë 13.02.2026 dhe datw 17.02.2026, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ofertues Agron Balukja më datë 16.01.2026, ka dorëzuar pranë komisionit të vlerësimit të ofertave mostrat e kërkuara, ku për artikullin objekt prokurimi

- Kosh metalik 1100 lt me mbishkrim Bashkia Cërrik
- Ndricues rrugor led 150W me panel
- Varg dritash 100 m
- Kapak zgare Celiku

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni sqaron se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Mostrat - referuar edhe legjislacionit në fuqi-, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pas verifikimit të mostrave të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor, K.P.P. konstaton se artikujt “Kapak zgare Celiku; Ndricues rrugor led 150W dhe Kosh metalik të dorëzuar në cilësinë e mostrës nga operatori ekonomik Agron Balukja janë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentat e tenderit. Përsa i përket artikullit Dekor vargje dritash Drita dekorative nga të dhënat në etiketën e ambalazhit të këtij artikulli konstatohet se referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në DST për artikullin vargu i dritave është përcaktuar që gjatësia e tij duhet të jetë 100 m. Ndërsa në etiketën e ambalazhit që shoqëron këtë artikull evidentohet gjatësia 50 m duke mos përmbushur kështu specifikimin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.2. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues Ervin Luzi mbi skualifikimin e e operatorit ekonomik “T & J Construction” SHPK për mos përmbushje nga ky I fundit të

kriterit 2.3.6 të DST Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht se me qellim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë një model të njësisë së tregtimit. Modeli duhet të paraqitet në datën dhe orën e hapjes së ofertave nga ana e OE.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “T & J Construction” SHPK me arsyetimin se: “Nuk ka paraqitur asnjë mostër sipas përcaktimit të pikës 2.3.6 në shtojcën nr 8 të DST”, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret ashtu siç pranon edhe vetë autoriteti kontraktor, operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas kërkesës së autoritetit kontraktor, pikës 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, të dokumentave të tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat ashtu edhe kur ato vlerësohen. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me dokumentacionin e dorëzuar duhet të vërtetojnë që mallrat/sërbimet/punët e ofruara janë në përputhje me kriteret/specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Rrjedhimisht në këto kushte mos dorëzimi nga ana e operatorit ekonomik “T & J Construction” SHPK të mostrave së kërkuara nga autoriteti kontraktor në ditën dhe orën e hapjes së ofertave përbën mos përmbushje të kriterit 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit nga ana e operatorit ekonomik. Rrjedhimisht kualifikimi i operatorit ekonomik “T & J Construction” SHPK nuk është i drejtë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik Ervin Luzi në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me REF-73621-01-05-2026 me objekt: “Blerje materiale për sektorin e mirëmbajtjes”, me fond limit 5,996,700 (pesë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Cërrik.
2. Autoriteti Kontraktor të rivlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë Agron Balukja dhe “T & J Construction” SHPK sipas konstatimeve të këtij vendimi duke i s’kualifikuar ata
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues Ervin Luzi
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

